



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë së Lirisë

Nr. 1404 Prot.

Tiranë, më 01. 04. 2026

K Ë R K E S Ë

KËRKUES:

39 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, anëtarë të Grupeve Parlamentare të Partisë së Lirisë dhe Partisë Demokratike.

OBJEKTI:

Krijimi i Komisioni Hetimor të Kuvendit, për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore.

BAZA LIGJORE:

Nenet 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës së Shqipërisë;
Neni 25 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë;
Ligji Nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvend”, i ndryshuar.

DREJTUAR:

Z. Niko Peleshi
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Z. Kryetar i Kuvendit,

Gjatë muajve të fundit, në mënyrë të veçantë gjatë muajit Shkurt 2026, kemi përjetuar dëmtime të jashtëzakonshme të infrastruktures rrugore të vendit, përfshirë dëmtime serioze të urave dhe veprave të tjera civile, që arritën kulmin në rrëshqitjet e trasesë së rrugës në aksin Jug-Lindor, me pasoja bllokimin e tij të plotë.

Dëmtime serioze patën segmentet Librazhd-Prrenjas, Qukës-Qafë Plloçë, Korçë-Ersekë, Unaza e Burrelit, Auro-moto-parku Elbasan, Dardhë-Boboshticë, Vllahinë-

Poçem, Lurë-Peshkopi, Kuç-Qeparo, Memaliaj-Tepelenë, Shëngjin-Velipojë, Tuneli i Llogarasë, Tuneli i Murrizit, e shumë vepra të tjera.

I një rëndësie të veçantë është segmenti Librazhd – Prrenjas, si pjesë e aksit Jug-Lindor dhe pjesë e Korridorit Ndërkombëtar VIII, pjesë e Korridoreve rrugore Evropiane.

Këto dëmtime të akseve rrugore kanë qenë me pasoja të jashtëzakonshme për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, për transportin kombëtar e ndërkombëtar, si dhe për ekonominë në përgjithësi.

Kryeministri dhe përfaqësues të tjerë të Qeverisë janë shprehur se këto dëmtime kanë ndodhur si rezultat i shirave të jashtëzakonshëm. Ndërkohë, që referuar shërbimit sinoptik, nuk ka patur nivele të pazakonta reshjesh.

Gjatë kësaj periudhe, mjaft inxhinierë dhe specialistë të ndërtimit të rrugëve kanë shprehur publikisht vërejtjet e tyre për mënyrën si realizohen këto vepra publike, duke nënvizuar probleme që kanë të bëjnë me projektet, me studimet gjeologjike, me supervizimin dhe inspektimin e punimeve, me respektimin kriterëve të sigurisë dhe të mirëmbajtjes, si dhe me respektimin e standardeve të vetë ndërtimit.

Gjatë periudhës 2014-2025 janë investuar në infrastrukturën rrugore rreth 4 miliard euro, një vlerë shumë e lartë e investimeve publike. Këto vlera të larta të përdorimit të parave të taksapaguesve janë një detyrim i rëndësishëm për t'u mirembajtur dhe për të gjetur e analizuar gjithë faktorët e amortizimit të shpejtë të tyre, me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë dhe rentabilitetit të investimeve sot dhe në të ardhmen.

Në këtë kuptim, ngritja e këtij Komisioni Hetimor Parlamentar ka për qëllim që të zbardhë plotësisht të gjitha veprimet dhe mosveprimet institucioneve përgjegjëse në realizimin e veprave të tilla, si dhe nxjerrjen e rekomandimeve për organet kompetente që personat përgjegjës të marrin përgjegjësitë përkatëse ligjore, si dhe të merren masat e përshtatshme që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

RRETHANAT E ÇËSHTJES

Dëmi i shkaktuar në infrastrukturën rrugore nga tërësia e faktorëve të sipërpërmendur është i vlerave tepër të larta dhe ka kompromentuar qëndrueshmërinë e investimeve të jashtëzakonshme, që janë realizuar në këtë sektor. Prandaj, hetimi i shkaqeve që kanë sjellë këtë situatë është një domosdoshmëri.

Duke patur parasysh se çështja e investimeve në infrastrukturë është një çështje ndërinstitucionale, ku përfshihen shumë institucione dhe entitete, Kuvendi duhet të kryejë funksionin e tij mbikqyrës dhe monitorues. Këtë detyrë Kuvendi mund dhe duhet ta realizojë edhe nëpërmjet Komisioneve Hetimore.

Përsa i përket aspektit të rëndësishëm të përmirësimit të punës në të ardhmen dhe përgatitjes së rekomandimeve për rritjen e efikasitetit të investimeve publike, është e rëndësishme të merren në shqyrtim edhe role e funksione që shkojnë përtej përgjegjësiave të ekzekutivit, siç mund të jenë Shoqatat e Profesionistëve të Ndertimit, Institute Shkencore e Projektimi, etj. Prandaj, angazhimi i Kuvendit në këtë sipërmarrje është i domosdoshëm.

ARSYETIMI LIGJOR

Gjykata Kushtetuese e cilëson si “kompetencë kushtetuese” të drejtën e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar. Duke e veshur një të katërtën e deputetëve me këtë pushtet, Kushtetuta “...institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushteti i pakicës parlamentare”, që realizohet “...në mënyrë të pavarur...” dhe që është “...i pakufizuar nga vullneti i shumicës”. E drejta e kontrollit hetimor i është njohur pakicës parlamentare, e cila duke i pasur të kufizuara mjetet në dispozicion, mund ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues.

Ushtrimi normal i veprimtarisë së Kuvendit kërkon ekzistencën e elementeve të domosdoshëm që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve për respektimin e ligjeve nga të gjitha organet e tjera të pushtetit publik dhe shtetasit, si dhe pajisjen e tij me mjetet e përshtatshme për realizimin e kontrollit mbi mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe mbrojtjen e interesit publik. Komisionet hetimore që ngrihen për këtë qëllim në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës, janë një mjet që i shërben pikërisht ushtrimit të kontrollit

parlamentar. Ato janë instrument i rëndësishëm i parlamentit për mbledhjen e informacionit për çështje të vecanta, me qëllim arritjen e përfundimeve të caktuara.

Qëllimi i Komisionit Hetimor që kërkohet të krijohet mbi bazën e kësaj kërkesë, synon që të mbledhë informacione të hollësishme mbi menyren e realizimit të investimeve publike dhe të rekomandojë përmirësimin e saj në të ardhmen, me qëllim rritjen e efektshmërisë dhe qëndrueshmërisë së investimeve publike.

Objekti dhe qëllimi i ngritjes së këtij Komisioni Hetimor është në përputhje me Kushtetutën dhe parimet themelore kushtetuese, për shkak se nuk sjell mbivendosje apo transferime të kompetencave të parashikuara nga Kushtetuta për organe të tjera.

Puna e Komisionit Hetimor nuk do të konsistojë në nxjerrjen e përgjegjësiave penale për personat e përfshirë në këtë çështje, pasi kjo është detyrë funksionale e organeve të drejtësisë.

Kërkesa për ngritjen nga Kuvendi të një komisioni hetimor, përmbush tri kriteret kushtetues si vijon: (i) çështja ka të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera për të cilat ai është i autorizuar të marrë masa ligjore; (ii) objekti i hetimit fokusohet në një çështje konkrete; dhe (iii) ekzistojnë të dhëna dhe indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e praktikave që dëmtojnë realizimin me efikasitet të investimeve.

Duke pasur parasysh sa më sipër, në përputhje me nenin 77 të Kushtetutës, nenin 25 të Rregullores së Kuvendit dhe ligjin Nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”,

KËRKOJMË:

1. Krijimin e një Komisioni Hetimor të Kuvendit, me:
 - (i) **Qëllim:** Kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve përgjegjëse për realizimin me standarde, me efikasitet e qëndrueshmëri të investimeve publike.
 - (ii) **Objekt:** a) verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve të Autoriteti Rrugor Shqiptar; b) verifikimi dhe testimi i respektimit të standarteve të ndërtimit

nga kompanite ekzekutuese. c) verifikimi dhe vleresimi i kapaciteteve te institucioneve, enteve e shoqatare te profesionisteve, ne funksion te garantimit te standarteve te larta ne projektimin dhe zbatimin e veprave publike. d) hartimi i rekomandimeve per te permiresuar punen ne te ardhmen.

(iii) **Përbërje:** 9 anëtarë, nga të cilët kryetari dhe 3 anëtarë do t'i përkasin grupeve parlamentare të opozitës dhe 5 anëtarë grupit parlamentar të mazhorancës.




(iv) **Afat:** 4 muaj nga krijimi i Komisonit Hetimor.

2. Mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve për shqyrtimin e kësaj kërkesë dhe caktimin e datës së miratimit në Kuvend në seancën plenare më të afërt.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Grupi Parlamentar i Partisë së Lirisë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

- | | |
|--------------------|------------------|
| 1) Tedi Blushi | 15. Xhuliel Mues |
| 2) Brunilda Haxhiu | 16. W. ... Bori |
| 3) Edmond ... | 17. ... |
| 4) Elise Xhixhe | 18. ... |
| 5) ... Borki | 19. ... |
| 6) Ina Zhupa | 20. ... |
| 7) Zija Ismaili | 21. ... |
| 8) Kastriot ... | 22. ... |
| 9) ... | 23. ... |
| 10) ... | 24. ... |
| 11) ... | 25. ... |
| 12) ... | 26. ... |
| 13) ... | 27. ... |
| 14) ... | 28. ... |

29. Manjole Luku H
30. Oed Isybbethi 
31. Gunt Shoozumr 
32. Bujar Lesing Byar 
33. Luam Boei dme 
34. Elde Hoti 
35. Benut Ruper 
36. Tit-shl 
37. Iui kaso 
38. Hron Gekmarky 
39. sal 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

VENDIM

Nr. ____/2026

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT, PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË DHE STANDARDEVE TE NDERTIMIT NE INFRASTRUKTUREN RRUGORE.

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, të neneve 5, 6, 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, i ndryshuar, me propozim të 39 deputetëve,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së 39 deputetëve, Kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve

përgjegjëse për realizimin me standarde, me efikasitet e qëndrueshmëri të investimeve publike.

II. Objekt i punës së Komisionit do të jetë:

- a) verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar;
- b) verifikimi dhe testimi i respektimit të standardeve të ndërtimit nga kompanitë ekzekutuese të punimeve.
- c) verifikimi dhe vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve, enteve e shoqatave të profesionistëve, në funksion të garantimit të standardeve të larta në projektimin dhe zbatimin e veprave publike.
- d) hartimi i rekomandimeve për të përmirësuar punën në të ardhmen.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese dhe ligjet e vendit.

IV. Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh që ofrojnë mbrojtje dhe garanci për cilësinë dhe qëndrueshmërinë e investimeve publike në infrastrukturë.

V. Komisioni hetimor përbëhet nga 9 anëtarë, si më poshtë:

- 1. _____ - Kryetar (PL)
- 2. _____ - Zëvendëskryetar (PS)
- 3. _____ - Anëtar (PL)
- 4. _____ - Anëtar (PD)
- 5. _____ - Anëtar (PD)
- 6. _____ - Anëtar (PS)
- 7. _____ - Anëtar (PS)
- 8. _____ - Anëtar (PS)
- 9. _____ - Anëtar (PS)

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 4-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

VII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që të caktojë menjëherë mjediset dhe mjetet e punës së Komisionit, personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion ekspertë juristë.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit, për mbarëvajtjen e punës së Komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Niko PELESHI

Miraturar më _____._____.2026